

URDHËR
Nr. 111, datë 5.2.2025

PËR SHFUQIZIMIN E URDHËRIT NR. 86, DATË 30.1.2025, “PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE ME PATOGJENITET TË LARTË TË SHPENDËVE TË SHFAQUR NË SHTETIN E PORTUGALISË”

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, nenin 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Shfuqizimin e urdhrit nr. 86, datë 30.1.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së Influcencës Aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve të shfaqur në shtetin e Portugalisë”.

2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Arian Jaupllari